UDHËZIM
Nr. 13, datë 5.6.2026

PËR PROCEDURAT DHE STANDARDET PËR KRYERJEN E PAGESAVE DHE MËNYRËN E PRANIMIT APO TËRHEQJES SË TYRE NË KATEGORINË "BASTE SPORTIVE *ONLINE*", NË ZBATIM TË MARRËVESHJES SPECIFIKE MIDIS ORGANIZATORIT DHE AGJENTIT FINANCIAR TË LICENCUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton procedurat dhe standardet minimale për pranimin e pagesave dhe autorizimin e tërheqjeve të tyre në kategorinë "Baste sportive *online*", që kryhen vetëm përmes agjentëve financiarë të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe në bazë të marrëveshjes specifike të lidhur ndërmjet organizatorit të lojës së fatit dhe agjentit financiar përkatës.
2. Udhëzimi është i detyrueshëm për të gjithë organizatorët e licencuar në kategorinë "Baste sportive *online*" dhe zbatohet për të gjitha kanalet elektronike të pranimit të pagesave dhe tërheqjeve.

Neni 2
Baza ligjore

Ky udhëzim mbështetet në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave", dhe për sa është e mundur, me aktet nënligjore zbatuese të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

1. "Agjent financiar" nënkupton ofruesin e shërbimeve të pagesave për organizatorin e basteve *online* me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, të parashikuar në shkronjat: "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimin e pagesave".
2. "Organizator", personi juridik i licencuar sipas ligjit nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të organizuar "Baste sportive *online*".
3. "Sistemi Qendror i Monitorimit *Online* (SQMO)" është sistemi i mbikëqyrjes në distancë dhe në kohë reale të organizatorëve që ushtrojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit nga AMLF-ja (Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit) nëpërmjet infrastrukturës teknike dhe kontrollit *online* të ushtrimit të aktivitetit të lojërave të fatit.
4. "Baste sportive *online*" janë bastet e vendosura në faqet e internetit, aplikacionet ose platformat elektronike të dedikuara, të autorizuara dhe të monitorueshme të subjekteve të licencuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën

e Shqipërisë", i ndryshuar, për ngjarjet sportive ose/dhe lojërat sportive të cilat do të ndodhin në të ardhmen dhe që nuk përfshijnë garat në pista.

5. "Lojtar" është personi që merr pjesë të luajë në kategoritë e lojërave të fatit, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në rregulloren e lojës së fatit.

6. "Llogari" janë llogaritë që hap lojtari apo organizatori i lojës pranë agjentit financiar të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

KREU II
PARIME DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 4
Parimet bazë

1. Organizatorit i ndalohet pranimi apo kryerja e pagesave me para në dorë. Çdo depozitë/tërheqje kryhet ekskluzivisht përmes agjentëve financiarë.

2. Çdo transaksion duhet të jetë i identifikueshëm në mënyrë unike dhe i gjurmueshëm në sistemet e organizatorit, të agjentit financiar dhe në SQMO.

3. Fondet e lojtarëve mbahen në llogari të veçanta pranë agjentit financiar të licencuar nga Banka e Shqipërisë, të cilat janë të autorizuara të ofrojnë shërbime bankare ose shërbime të pagesave në përputhje me ligjin nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave".

KREU III
MARRËVESHJA SPECIFIKE NDËRMJET ORGANIZATORIT DHE AGJENTIT FINANCIAR

Neni 5
Përmbajtja minimale e marrëveshjes specifike

Marrëveshja specifike ndërmjet organizatorit dhe agjentit financiar duhet të parashikojë minimalisht:

1. Rolin dhe detyrat e palëve, përfshirë mënyrën e funksionimit të shërbimit, afatet e përpunimit të transaksioneve dhe mënyrën se si trajtohen problemet teknike ose operacionale, duke përcaktuar qartë detyrimet e organizatorit dhe detyrimet e agjentit financiar, në përputhje me ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave".

2. Përcaktimin e detyrimeve të palëve, në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e klientëve, ku:

a) organizatori kryen identifikimin dhe verifikimin e lojtarit, në përputhje me legjislacionin për lojërat e fatit dhe aktet rregullatore të AMLF-së;

b) agjenti financiar kryen procedurat e identifikimit të përdoruesit të shërbimeve të pagesave sipas kërkesave të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave" dhe akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Agjenti financiar nuk verifikon statusin e lojtarit si "lojtar", por vetëm identitetin e përdoruesit të shërbimeve të pagesave;

c) në momentin e regjistrimit, lojtari nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës autorizon AMLF-në që në çdo kohë të kërkojë, të verifikojë të dhënat dhe të marrë informacion nga bankat lidhur me transaksionet e kryera si lojtar në llogaritë e tij.

3. Kanalet e lejuara të pagesave dhe të dhënat e detyrueshme që agjenti financiar duhet t'i transmetojë organizatorit për çdo transaksion, duke përfshirë numrin unik të transaksionit, identitetin e paguesit, shumën, monedhën, tarifat e aplikuara, datën dhe kohën e transaksionit,

dhe kursin e këmbimit kur zbatohet, në formatin dhe frekuencën e dakordësuar ndërmjet palëve.

4. Standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe të sigurisë, përfshirë protokollet e komunikimit, enkriptimin, kontrollet e aksesit, ruajtjen dhe auditueshmërinë e të dhënave, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimet që secila palë ka sipas kuadrit rregullator përkatës.

5. Përcaktimin e procedurave që organizatori ndjek për menaxhimin e incidenteve teknike ose operacionale që ndikojnë në pranimin e pagesave dhe funksionimin e sistemit të lojës, duke përfshirë klasifikimin e incidenteve, afatet e njoftimit dhe mënyrat e rikuperimit të shërbimit, në përputhje me kërkesat e nenit 16 të këtij udhëzimi. Detyrimet për menaxhimin e incidenteve të agjentit financiar zbatohen sipas kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë dhe nuk janë objekt i kësaj marrëveshjeje.

6. Përcaktimin e rregullave për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet agjentit financiar dhe organizatorit, duke garantuar që agjenti financiar i transmeton organizatorit të gjitha të dhënat e nevojshme të transaksioneve për t'u raportuar në SQMO nga organizatori, sipas kërkesave të AMLF-së. Detyrimi për raportimin në SQMO dhe përshtatjen e sistemit sipas kërkesave të AMLF-së i takon vetëm organizatorit.

KREU IV
REGJISTRIMI, VERIFIKIMI DHE MBROJTJA E LOJTARIT

Neni 6
Regjistrimi dhe verifikimi i lojtarëve

1. Organizatori regjistron dhe ruan të dhënat e identifikimit të lojtarit dhe dokumentacionin shoqërues për një periudhë jo më pak se pesë (5) vjet, në përputhje me nenin 16 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Organizatori verifikon identitetin e lojtarit përpara përdorimit të llogarisë së lojës, duke u siguruar që mjeti i pagesës, i përdorur për depozitim ose tërheqje, i përket të njëjtit person. Në rast se pas verifikimit rezulton mospërputhje midis identitetit të lojtarit dhe identitetit të mbajtësit të mjetit të pagesës, organizatori refuzon transaksionin dhe, kur është e nevojshme, kthen shumën te mjeti i pagesës nga i cili ka ardhur.

3. Lejohet vetëm një llogari (*account*) lojtari në sistemin e organizatorit, e cila nuk përbën llogari pagese apo llogari bankare. Nuk pranohen lojtarë nën 21 vjeç ose lojtarë të përfshirë në listën e vetëpërjashtimit të administruar nga AMLF-ja.

Neni 7
Vetëpërjashtimi dhe kufizimet

Organizatori aktivizon shërbimin e vetëpërjashtimit ≤24 orë dhe zbaton menjëherë kufizimet për llogaritë e vetëpërjashtuara.

KREU V
PROCEDURAT E DEPOZITIMIT DHE TËRHEQJES

Neni 8
Depozitimet e lojtarëve

1. Depozitimet pranohen të kryhen vetëm nga mjete pagese që janë në emër të lojtarit, si llogari pagese, kartë ose portofol elektronik, të cilat identifikohen qartë se i përkasin të njëjtit person me lojtarin. Agjenti financiar verifikon identitetin e mbajtësit të mjetit të pagesës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave" dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë, ndërsa organizatori siguron përputhjen midis identitetit të lojtarit dhe mbajtësit të mjetit të pagesës përpara pranimit të depozitimit. Organizatori mund të vendosë kufij ditorë, javorë ose mujorë të depozitimit, me qëllim mbrojtjen e lojtarit dhe integritetin financiar të aktivitetit, të cilët publikohen qartë në platformën e lojës.

2. Sistemi i organizatorit refuzon automatikisht çdo depozitim kur nga të dhënat e transmetuara nga agjenti financiar rezulton mospërputhje midis identitetit të lojtarit dhe mbajtësit të mjetit të pagesës ose kur përdoret një mjet pagese i lëshuar në emër të një pale të tretë.

3. Për çdo depozitim, agjenti financiar i dërgon organizatorit të gjitha të dhënat e transaksionit, përfshirë numrin unik të transaksionit, emrin/identitetin e paguesit (lojtarit), shumën dhe monedhën, tarifat e aplikuara, kursin e këmbimit kur zbatohet, si dhe datën dhe kohën e kryerjes së transaksionit.

Neni 9
Tërheqjet e fondeve

1. Tërheqjet kryhen në të njëjtën mënyrë si depozitimet, duke përdorur të njëjtin mjet pagese me atë që ka përdorur lojtari. Tërheqja nuk mund të kreditohet drejtpërdrejt në kartë, por vetëm në llogarinë e pagesës, të lidhur me mjetin e pagesës së lojtarit.

2. Përpara kryerjes së tërheqjes, organizatori kontrollon nëse fitimi vjen nga një lojë e kryer rregullisht, ku lojtarit i është kryer verifikimi dhe që mjeti i pagesës është në përputhje me të dhënat identifikuese të lojtarit.

3. Pagesat e fitimeve bëhen vetëm në llogarinë personale të lojtarit, në të njëjtën llogari pagese ku janë kryer depozitimet. Nuk lejohet kreditimi i fitimeve në llogari të personave të tretë ose në mjete pagese që nuk i përkasin lojtarit.

Neni 10
Ndalime dhe kufizime

1. Nuk lejohet që pagesat të kryhen nga ose drejt personave të tjerë për llogari të lojtarit. Të gjitha pagesat duhet të bëhen vetëm nga vetë lojtari.

2. Organizatori identifikon rastet e transaksioneve të pazakonta ose të paarsyeshme (për nga shuma, shpeshtësia ose mënyra e pagesës) dhe i trajton ato në përputhje me kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë vlerësimin e rrezikut dhe raportimin e rasteve të dyshimta. Refuzimi i transaksionit bëhet vetëm në rastet kur zbatimi i masave të verifikimit të identitetit është i pamundur, sipas neneve 4/1 dhe 7, të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Rastet e dyshimta identifikohen, dokumentohen dhe raportohen pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF), në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Paralelisht, kur rasti lidhet me lojën, pagesat ose funksionimin e sistemit, organizatori njofton edhe AMLF-në."

KREU VI
RREGULLAT PËR PROMOCIONET DHE BONUSET E LOJËS

Neni 11

Rregulla të posaçme

1. Promocionet nuk përbëjnë fonde reale të lojtarit dhe nuk mund të tërhiqen, përveçse kur lojtari plotëson kushtet e përcaktuara nga organizatori për përdorimin ose shndërrimin e tyre në fonde reale.

2. Organizatori mban të ndara balancën e fondeve reale dhe balancën e fondeve promocionale të lojtarit dhe nuk i përzien ato deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara për përdorimin e fondeve promocionale.

3. Fondeve promocionale u njihet statusi i detyrimit të organizatorit dhe ato pasqyrohen në mbulimin financiar, sipas nenit 13 të këtij udhëzimi.

KREU VII
NDARJA, RUAJTJA DHE KONTROLLI I FONDEVE

Neni 12
Llogaria e veçantë e fondeve të lojtarëve

Organizatori mban një llogari të veçantë, të hapur vetëm pranë agjentit financiar të licencuar në Republikën e Shqipërisë, ku ruhen ekskluzivisht fondet e lojtarëve. Kjo llogari nuk përbën llogari individuale të lojtarëve, por një llogari të organizatorit e dedikuar për mbajtjen dhe administrimin e këtyre fondeve. Nëse organizatori nuk është më në gjendje të përmbushë detyrimet e tij, fondet e mbajtura në këtë llogari u kthehen lojtarëve me përparësi ndaj çdo kreditori tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13
Rakordimi ditor i fondeve dhe trajtimi i mospërputhjeve

1. Organizatori kryen çdo ditë rakordim midis gjendjes së llogarisë së fondeve të lojtarëve, balancave të lojtarëve në sistem dhe transaksioneve në pritje.

2. Gjendja në llogarinë duhet të jetë gjithmonë e barabartë ose më e madhe se shuma totale e balancave të lojtarëve plus transaksionet në pritje.

3. Në rast të një mospërputhjeje negative, organizatori e korrigjon brenda ditës së nesërme (jo më vonë se ora 12:00) dhe njofton AMLF-në brenda 24 orëve. Tepricat korrigjohen sipas rregullave kontabël, pa prekur ose cenuar në asnjë mënyrë të drejtat e lojtarëve.

4. Të gjitha dokumentet dhe evidencat e përputhjes ditore vihen në dispozicion të AMLF-së dhe SQMO-së sipas kërkesës.

KREU VIII
MONITORIMI, RAPORTIMI DHE SQMO-ja

Neni 14
Monitorimi në kohë reale dhe akseset e AMLF-së

1. Organizatori siguron lidhje të vazhdueshme me sistemin SQMO dhe i jep AMLF-së akses të plotë në sistemet e tij, për monitorimin në kohë reale të pagesave dhe tërheqjeve.

2. Çdo ndryshim i rëndësishëm në sistemet teknologjike të organizatorit që lidhen me pranimin, përpunimin ose ekzekutimin e pagesave (p.sh. *software*, pajisje apo mënyrën e funksionimit të tyre) kërkon miratim paraprak nga AMLF-ja, sipas procedurave të përcaktuara prej saj. Këto ndryshime nuk kanë lidhje me sistemet e pagesave në kuptimin e legjislacionit "Për sistemin e pagesave", të cilat mbeten nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë.

Neni 15
Raportimi mujor dhe formatet e raportimit

1. Organizatori i paraqet AMLF-së, çdo muaj, një raport që përmban: shumat e luajtura, fitimet e paguara, depozitat dhe tërheqjet neto, të ardhurat bruto nga loja, numrin e lojtarëve aktivë, transaksionet me vlerë 1 000 000 lekë e sipër, si dhe gjendjen e fondeve të lojtarëve dhe llogarisë në fund të muajit.

2. Formati dhe mënyra e dorëzimit të raportit përcaktohen nga AMLF-ja dhe duhet të jenë të përputhshme me sistemin SQMO.

KREU IX
TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMTA, INCIDENTEVE DHE ANKESAVE

Neni 16
Incidentet operative dhe njoftimi i AMLF-së

1. Organizatori klasifikon incidentet sipas rëndësisë kritike, të mëdha ose të vogla.

2. Për incidentet kritike, organizatori njofton AMLF-në brenda 24 orëve dhe dokumenton shkakun, masat e marra dhe veprimet parandaluese.

3. Për incidentet e klasifikuara si të mëdha, organizatori njofton AMLF-në brenda 72 orëve nga identifikimi i tyre, duke dhënë informacion mbi natyrën e incidentit, ndikimin e tij dhe masat korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara.

4. Incidentet e vogla dokumentohen nga organizatori dhe njoftohen pranë AMLF-së në mënyrë periodike ose me kërkesë të posaçme të saj, kur këto incidente tregojnë raste të përsëritura në sistemet ose procedurat e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit.

Neni 17
Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

1. Organizatori zbaton të gjitha masat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë, por pa u kufizuar në identifikimin dhe verifikimin e klientit, monitorimin e transaksioneve dhe raportimin e rasteve të dyshimta pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF), në përputhje me legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. AMLF-ja njoftohet nga organizatori vetëm në rastet kur rasti lidhet me funksionimin e lojës, pagesat ose aktivitetin e licencuar.

2. Nëse ka dyshim të arsyeshëm për veprim të parregullt, organizatori mund të bllokojë përkohësisht transaksionin ose llogarinë dhe njofton menjëherë AMLF-në dhe autoritetet përkatëse.

Neni 18
Trajtimi i ankesave të lojtarëve

1. Organizatori siguron një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për pranimin dhe trajtimin e ankesave të lojtarëve.

2. Ankesat regjistrohen dhe trajtohen brenda një afati të arsyeshëm, por jo me vonë se 30 ditë kalendarike nga paraqitja e ankimit, duke garantuar një përgjigje të argumentuar për lojtarin.

3. Në rastet kur ankesa lidhet me lojën, pagesat ose të dhënat e lojtarit, organizatori vë menjëherë në dispozicion të AMLF-së dokumentacionin përkatës, përfshirë të dhënat e SQMO-së, sipas kërkesës.

4. Organizatori publikon qartë mënyrat e paraqitjes së ankesave dhe afatet e trajtimit të tyre.

5. Lojtari ka të drejtë të ankimojë pranë AMLF-së nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen e organizatorit.

KREU X
INTEGRITETI, AUDITUESHMËRIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 19
Gjurmueshmëria e transaksioneve

1. Çdo transaksion regjistrohet me një kod unik dhe duhet të përmbajë referencën, identitetin e lojtarit, datën dhe kohën, kanalin, shumën/monedhën, identifikuesin e agjentit financiar, komisionet, statusin dhe lidhjen me biletën ose porosinë e lojës.

2. Të gjitha të dhënat dhe evidencat e transaksioneve ruhen për një periudhë jo më pak se pesë (5) vjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për qëllime kontrolli dhe auditimi.

Neni 20
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave të lojtarëve nga organizatori dhe agjenti financiar kryhet vetëm në masën e nevojshme për ofrimin e shërbimit, parandalimin e mashtrimit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

2. Organizatori dhe agjenti financiar sigurojnë mbrojtjen, konfidencialitetin dhe minimizimin e të dhënave, duke i përdorur vetëm për qëllimet e lejuara dhe duke i ruajtur sipas afateve ligjore.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21
Dispozita të fundit dhe hyrja në fuqi

1. Mosrespektimi i këtij udhëzimi përbën shkelje të legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit dhe sanksionohet sipas nenit 53, të ligjit nr. 155/2015, i cili parashikon masat administrative deri në pezullimin ose revokimin e licencës.

2. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit të këtij udhëzimi, vlerëson në mënyrë të vazhdueshme efektivitetin e tij dhe, sa herë që konstaton nevojën për përmirësime, plotësime apo rishikime, me qëllim ruajtjen e standardeve të sigurisë, integritetit dhe funksionimit të tregut, i propozon ministrit të Financave ndryshimet përkatëse për miratim.

3. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, organizatorët e basteve sportive *online* dhe agjentët financiarë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj